

AKT THEMELIMI

I

SHOQĒRISE TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR "AL-DANASIO" SHPK

Sot më date 25.03.2024 une, i nenshkruar:

Gëzim Daçi, i datëlindjes 23/09/1971, banues në Durrës, madhore, me zotesi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. H10923093L

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", hartoj këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin "AL-DANASIO" SHPK. Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare "AL-DANASIO" SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar do të ketë seline e saj qëndrore ne Lagjja nr. 5, Rruga Mujo Ulqinaku, Godine me numer pasurie 7/468, Zona Kadastrale 8513, Durres.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti I veprimitarise

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Tregtim, import – eksport, shitblerje e mallrave ushqimore të çdo lloji, kryesisht cigareve, cigareve elektronike, vape dhe produkteve te lidhura me to, te produkteve me permbajte nikotine, mallrave te ndryshme industriale, etj. Magazinimi i materialeve, nënprodukteve ose produkteve të sipër përmendura.

Tregtimi, Importimi dhe eksportimi i çdo produkti apo malli i çfareolloj natyre, qofte i gatshem apo gjysem i gatshem, i perpunuar apo i paketuar ose jo; importimi dhe eksportimi i çdo lloj makinerie, materiali qe eshte i nevojsphem per ushtrimin e veprimitarise se siperpermendorur

Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit per vehte per te trete e me qira.

Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë te pakufizuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar SHPK është 900.000 (nenteqindmije) Leke, e ndarë në 1 kuotë, i cili është nënshkruar nga ortaku i vetëm.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të Shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z. Gëzim Daçi është ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili zoteron 1 kuotë, të barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë ne vleren 900.000 leke.

NENI 9

Organet e shoqërisë

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcione pjesëmarrjen e tyre në kapital.



NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori shoqërisë është Z. Gëzim Daçi.

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

ORTAKU THEMELUES

Z. Gëzim Daçi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Z. Gëzim Daçi". The signature is written in a cursive style with a blue pen.